



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1915 Prot.

Roskovec, më 28.04 2020

VENDIM

NR. 27 .DATË 27.04 .2020

“Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Roskovec, për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe përjashtimit nga procesi i legalizimit”

Në mbështetje të Kodi Civil nenet : 83, 705, 750 dhe 751; të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1.2 gërmat 'a' dhe 'c', neni 24 pika 2, neni 54 gërma 'e'; Ligji Nr.8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar, nenet 11 e 12; Ligjit Nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 8 ; të ligjit Nr.22,2018 "Për strehimin social" neni 13 pika 1 gërma 'b' paragrafi "iii", neni 16, gërma 'a' paragrafi 'vi', neni 44 pika 2, neni 49 pika 1 ; si dhe Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr.76 datë 18.10.2018 "Për miratimin e investimit për ndërtimin e një godine 3-katëshe për strehim social" dhe Nr.84 datë 18.10.2018 "Për pagesën e qerasë për familjet në nevojë", konfirmuar mbi ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut me shkresë Nr.1720 /1 prot.datë 01.11.2018 ;Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin për shitjen e pronave publike në pronësi të bashkisë Roskovec sipas vërtetimit hipotekor Nr.02 datë 24.04.2020, bashkëlidhur.
- 2- Miratimin për shitjen e pronave publike, respektivisht 3 (tre) apartamenteve, familjeve të cilat kanë rezultuar të pastreha si rezultat i zbatimit të projektit për interes publik "Rikualifikimi urban dhe zhvillimor i bllokut nr.2, qendra e qytetit Roskovec", banesat e të cilëve prishen për shkak të interesit publik, janë përjashtuar nga procesi i legalizimit dhe që nuk shpronësohen, konkretisht familjet banorë të bashkisë Roskovec, me kryefamiljar:

1-Shkëlqim Begaj

2-Naxhie Driza

3-Fatmir Kasëmaj



- 3- Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së këtyre pronave të paluajtshme nëpërmjet shitjes, do të kryhet me akt noterial dhe do të regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi.
- 4- Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Juridike për zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Bashkëlidhur relacioni shpjegues.

KRYETAR
Kadri Hyska

